

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/9/19;
Datë: 19.09.2019 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:



FTESË

Për: anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Muharrem Krasniqi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: mbledhje e nëntë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 27.09.2019, ora 14⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Raporti gjashtëmuor financiar Janar-Qershor 2019,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Rregullores për tatimin e mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020 (Leximi i parë);
4. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit 2020-2022,
5. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2019,
6. Kërkesë për lirimin nga detyra dhe zëvendësimin e anëtares së KK PPAK, znj Aida Zeqaj,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së KPSH-ës 2020-2024 (leximi i dytë),
8. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	12.09.2019
PËR/ZA/TO:	Muharrem Krasniqi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Agron Kuçi – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Kosovare Gacaferi- Drejtore e Buxhetit dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2019, Sipas këtyre programeve

E hyra vetanake për vitin 2019 sipas planifikimit dhe realizimit

Tabela e planit dhe realizimit:

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi Janar – Gusht 2019	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	7,231.00	34,269.00	27,038.00
2	Te hyrat nga urbanizmi	11,200.00	590.00	-10,610.00
3	Te hyrat nga administrata	6,200.00	5,539.00	-661.00
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	4,500.00	11,759.36	7,259.36
5	Te hyrat nga tatimi ne pronë dhe në tokë	53,926.00	55,238.45	1,312.45
6	Regjistrimi i Automjeteve	7,600.00	4,194.00	-3,406.00
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,200.00	4,464.60	-1,735.40
8	Të hyrat tjera	16,700.00	8,095.50	-8,604.50
	TOTALI	113,557.00	124,149.91	10,592.91

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Gusht 2019 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **124,149.91€**. Shuma e planifikuar për vitin 2019 është **113,557.00€**, ku shifet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake në këtë periudhë në vlerë prej 10,592.91€ dhe gjithashtu e kemi në dispozicion edhe periudhën Shtator-Dhjetor 2019 që presim të inkasojmë të hyra vetanake.

Ne mënyrë që të mundemi të alokojmë tejkalimin e të hyrave dhe mjetet që do të inkasohen në periudhën në vazhdim të këtij viti, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej **25,000.00€**, totali i të hyrave për vitin 2019 të rritet nga 113,557.00€ në 138,557.00€.

Kjo rritje në vlerë prej 25,000.00€ të bartet në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme nën programi 16320 Administrata- Junik kodi funksional 0133 në kategorinë e shpenzimeve kapitale sipas këtyre specifikave.


5,000.00 € në projektin ekzistues “Ndërtimi i aneksit në objektin e Komunës” me kod të projektit 48470.

20,000.00 € në një projekt të ri “Ndërtimi i E-kioskit në Objektin e Komunës”

Ju faleminderojmë për mirëkuptim!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



R-155/8037
2
10 09 2019

DATË/A:	09.09.2019
PËR/ZA/TO:	Muharrem Krasniqi- Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Agron Kuçi -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Kosovare Gacaferi- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF dhe Komitetin për Komunitete, shqyrtimin e projekt Rregullores për Tatimin mbi Pronën e paluajtshme për vitin 2020 (Leximi i parë)

Në bazë të rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Junikut të nenit 16, paragrafi 1 (e), pika 8, ku thuhet: shqyrtimi i projekt rregulloreve duhet të kalojë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete kërkojmë nga ju që ta shqyrtoni projekt Rregulloren e Tatimit mbi Pronën e paluajtshme për vitin 2020.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
Kuvendi Komunal – JUNIK - Skupština Opštine – Municipal Assambly

RREGULLORE PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2020

**Komuna Junik
Shtator, 2019**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-204, të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nenit 9, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 12.2 pika c, si dhe Statutit të Komunës neni 20, Kuvendi Komunal i Junikut në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 00.00.0000 aprovon këtë:

RREGULLORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2020

Neni 1 Baza Tatimore

Për vitin 2020 zonat tatimore dhe nivelet e vlerave për m² në Komunën e Junikut caktohen si vijon:

Tabela 1: Zonat tatimore në bazë të vlerës së tregut në m²

Kategoria e Vlerës	Nivelet e vlerave për m ²				
	Zona I	Zona I-A	Zona II	Zona III	Zona IV
1. Pronë rezidenciale					
1.1. Shtëpi familjare					
1.2. Apartament					
1.3. Garazh për shfrytëzim privat					
1.4. Objekt tjetër rezidencial					
2. Pronë komerciale					
2.1. Shitore	490	440	380	320	290
2.2. Zyrë	470	450	390	340	260
2.3. Restorant	470	420	370	300	210
2.4. Hotel	470	420	370	300	210
2.5. Objekt për magazinim komercial	270	220	190	150	100
2.6. Garazh komercial	130	120	100	50	30
2.7. Pishinë për shfrytëzim komercial	130	120	110	100	90
2.8. Fushë e hapur sportive	130	120	110	100	90
2.9. Fushë e mbyllur sportive	130	120	110	100	90
2.10. Pompë benzine	500	470	450	420	400
2.11. Objekt tjetër komercial	400	350	300	220	160
3. Pronë industriale					
3.1. Fabrikë	290	250	230	210	190
3.2. Punishte	270	230	210	190	160
3.3. Objekt për magazinim industrial	230	180	160	110	60
3.4. Objekt tjetër industrial	220	170	150	100	60

Neni 2 Zonat tatimore

Bazuar në vlerën e tregut të Pronave të Paluajtshme, territori i Komunës së Junikut ndahet në pesë zona tatimore, siç vijon:

Zona e I - përfshin të gjitha objektet që kanë dalje në të dy anët e rrugës magjistrale dhe lokale, ku përfshin rrugën nga Qendra e Junikut e deri të Biblioteka “Dinë Mehmeti”, rruga nga Qendra e Junikut deri te Stacioni i Autobusëve, rruga nga Qendra e Junikut e deri te stacioni policor, rruga nga Qendra e Junikut (rruga për Dobrosh) e deri të udhëkryqi i rrugës së Berishës dhe rruga nga Qendra e Junikut e deri te Qendra e Mjekësisë Familjare.

Zona e I -A - përfshirë gjitha objektet që kanë dalje në rrugën kryesore nga Biblioteka “Dinë Mehmeti” e deri tek Qendra për Punë dhe Mirëqenie Sociale, rruga nga stacioni i autobusëve deri tek restaurant “Oda e Junikut”, rruga nga stacioni policor e deri tek varrezat e Gacaferit, rruga nga udhëkryqi i Berishës e deri te bunari i fushës, rruga nga Qendra e Mjekësisë Familjare e deri tek palestra sportive “Ereniku”.

Zona e II - përfshinë të gjitha objektet dhe lokalet pas përfundimit të zonës së parë A dhe objektet tjera të banimit në lagjet: Gacafer, Pepsh, Bajraktarë, Berishë, Miroc-Malok , Qok, Gaxherr i Ulët dhe i Epërm dhe lagjja Agim Ramadani - e cila dallon nga zona industriale.

Zona e III - përfshinë të gjitha hapësirat të cilat nuk janë të përfshira në zonën e I-rë dhe zonën e II –të, e që i përkasin Qytetit të Junikut: lagja **Goç** dhe objektet tjera të banimit të cilat gjenden në periferi të lagjeve të cekura në zonën e dytë.

Zona e IV - janë të përfshira te gjitha hapësirat jashtë Qytezës së Junikut: fshatrat, Jasiq, Gjocaj dhe ekofshatrat Gropa e Erenikut, Qërrshiza, Rrasa e Zogut dhe Pllaqica vendbanime në bjeshkët e Junikut.

Neni 3 Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Junikut, cakton normat tatimore për vitin 2020 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

Tabela 2: Normat Tatimore sipas kategorisë së Pronës për vitin 2020

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.16 %
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15 %
Për njësitë pyjore të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.16 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.16 %
Për njësitë komerciale të parcelave	0.17 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.17 %

Për njësitë industriale të parcelave	0.18 %
Për njësitë industriale të objekteve	0.18 %

Neni 4 Shfuqizimi

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren e Tatimit mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2020.

Rregullorja i dorëzohet:

1. Komitetit për politikë dhe Financa,
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
3. Ministrisë për Financa
4. Sektorit të Tatimit në Pronë
5. Arkivit komunal

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Muharrem Krasniqi

(Nënshkrimi)



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Numër: 02– 08/19
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	30.08.2019
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tetë rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 30.08.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti, nënkryetarin z. Faik Tofaj, përfaqësuesen e OSBE-së, Komandatin e Stacionit Policor në Junik, përfaqësues të KFOR-it, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

Anëtarët prezent

- | | |
|-------------------------------------|-----------------------------------|
| 1. Muharrem Krasniqi -kryesues, AAK | 8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK |
| 2. Behare Qestaj – anëtare, AAK | 9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK |
| 3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK | 10. Edona Shehu –anëtare, LDK |
| 4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK | 11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK |
| 5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK | 12. Kreshnik Maloku – anëtar, PDK |
| 6. Dardane Shala – anëtare, AAK | |
| 7. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK | |

Munguan: z. Zenel Maloku, z. Lulzim Gacaferi dhe znj. Luljeta Jasiqi

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrje fshirjeve në Komunën e Junikut për vitin 2019
3. Informatë për përgatitjet e vitit shkollor 2019/2020
4. Të ndryshme

Znj. Behare Qestaj: ne pajtohemi me këtë rend dite

z. Tahir Isufaj: pajtohemi

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim rendin e ditës dhe konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

1 Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka rreth procesverbalit, konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

pika e dytë:

2. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrje fshirjeve në Komunën e Junikut për vitin 2019

z. Muharrem Krasniqi: fjala për ju të nderuar kolegë

znj. Behare Qestaj: si grup nuk kemi diçka për të shtuar

z. Tahir Isufaj: e kishi shkruar që toka e Junikut është shumë mirë, ka rendimente të mira, e nuk e ka as ujitjen as kanalet qka i keni bërë ju

z. Muharrem Krasniqi: për këtë pikë nuk votohet

pika e tretë:

3. Informatë për përgatitjet e vitit shkollor 2019/2020

z. Fatos Shala: po ua paraqes përgatitjet për vitin shkollor, vlen të ceket se këtë javë kemi pasur takime me Ministrinë e Arsimit dhe kemi biseduar për objektin e ri të shkollës në shkollën fillore dhe sallën sportive në gjimnazin e Junikut presim që shpejt ato dy projekte me fillu. Raportin e keni të bashkëngjitur

znj. Behare Qestaj: nuk kemi diçka për të shtuar

z. Tahir Isufaj: kam në emër të grupit dhe timin, në shkollën fillore janë 646 nxënës e gjithsej 30 paralele e që i bjen 22 nxënës për klasë, shkolla e mesme i ka 210 nxënës, me 10 paralele, që i bjen 21 nxënës në klasë, si po e mani kuadrin shkollor. Shqetësuese është te klastë e X 3 paralele me 73 nxënës, te klastë e XI 3 paralele me 71 nxënës, si është e mundur

z. Fatos Shala: kjo është gjendja reale, kjo gjendje është në krejt Kosovë, Ministria e Arsimit kur e ka pa që po largohen fëmijet, na ka rekomandu që asnjë nxënës mos me e largu nga procesi i mësimi, edhe nëse ndonjë mësues mbet pa nxënës mos me e largu por me e aktivizu si ndihmës.

z. Muharrem Krasniqi: në gjimnazin e Junikut janë 2 drejtime, tash ka ardhë edhe Mjekësia janë bërë 3, prandaj nr i nxënësve mundet me qenë një klasë më i vogël një më i madh. E sa i përket 22 nxënës për një klasë nuk janë pak. Është me ligjin parauniversitar e cekne mbi 35 nxënës klasa duhet me u nda në dy.

z. Tahir Isufaj: klasët e X, janë 3 paralele me 73 nxënës, ne jemi ka e mashtrojmë veten këtu.

Znj. Behare Qestaj: testi i maturës, që ka qenë me 30 gusht po më intereson sa maturantë kanë marrë pjesë në këtë test?

z. Fatos Shala: kanë qenë 30, kanë hi në test 26, ndërsa 4 nuk kanë pas drejtë me hi në test

pika e katër

4. Të ndryshme


z. Tahir Isufaj: e kisha bërë një propozim që për mbledhjen e ardhshme me i diskutu këto investime që janë bërë deri me tani për këtë vit edhe me e ditë qka është bërë dhe qka është ndërtuar, sidomos për rrugën Junik-Drenoc dëgjova që edhe kanalizimi po hyn andej, këtë kemi me e sqaru përndryshe ajo si lëndë do të shkoj tjetër kund

z. Muharrem Krasniqi: besoj që kemi me e pas në Janar raportin e Kryetarit dhe i trajtojmë të gjitha, a ka dikush diçka tjetër nëse jo me kaq e mbylli këtë mbledhje

Takimi përfundoi me punë në ora 14:25


E përgatiti
z. Turim Ganiqaj

Kryesues i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi



155/7099
12 09 2019

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK




DATE/A:	10.09.2019
PËR/ZA/TO:	Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Agron Kuçi - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Kosovare Gacaferi - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në LPF shqyrtim dhe miratimin e Buxhetit për vitin 2020-2022

Në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr: 03/L-048 neni 20, Ligji për vetëqeverisje lokale nr:03/L- 040, neni 24 dhe ligji për Financat e Pushtetit lokal nr:03/L -049 neni 23, 24 , 25 dhe në bazë të limiteve nga Ministria e Financave në përputhje me Qarkoren e Dytë Buxhetore 2020/02, kërkojmë që të shqyrtohet dhe miratohet Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2020-2022.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK




DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

(Projekt)

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
KOMUNALE**

2020- 2022

JUNIK, 2019



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	10.09.2019
PËR/ZA/TO:	Muharrem Krasniqi– Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Agron Kuçi -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Kosovare Gacaferi- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF shqyrtim dhe miratimin e Buxhetit për vitin 2020-2022



Në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr: 03/L-048 neni 20, Ligji për vetëqeverisje lokale nr:03/L- 040, neni 24 dhe ligji për Financat e Pushtetit lokal nr:03/L -049 neni 23, 24 , 25 dhe në bazë të limiteve nga Ministria e Financave në përputhje me Qarkoren e Dytë Buxhetore 2020/02, kërkojmë që të shqyrtohet dhe miratohet Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2020-2022.

I. KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR K.K – JUNIK

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po e paraqesim këtu është një dokument i cili miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Shpenzimet janë planifikuar ashtu që të pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuara në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit. Hartimi i KAB-it 2020-2022 është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Buxhetore 2020/01 për Komunal, lëshuar nga Ministria e Financave. Ne kemi shqyrtuar KAB-in në kuptim të planifikimit afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Parashikimet ekonomike dhe buxhetore;
- Strategjinë zhvillimore komunale;
- Totalët e vlerësuar të të hyrave nga të gjitha burimet e financim;
- Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe ;
- Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave
- Paraqitja e prioritetëve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritetet dhe rezultatet e arritura.
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioritetëve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe caqeve për të matur progresin drejt prioritetëve strategjike dhe rezultateve

KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2020-2022.

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Junikut është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2020/2022 të dhëna nga MF-ve përmes qarkores buxhetore 2020/01 .

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunal do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Junikut

si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2020 – 2022, gjithnjë duke u bazuar në :

1. Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
2. Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
3. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
4. Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

II. OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Me kornizën afatmesme buxhetore 2020–2022 të Komunës së Junikut synohen të arrihen këto objektiva:

- ❖ Zhvilloj, promovoj dhe rigjeneroj infrastrukturën lokale;
- ❖ Përmirësoj ambientin për të jetuar;
- ❖ Përmirësoj sigurinë dhe shëndetin e komunitetit;
- ❖ Zhvilloj sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit;
- ❖ Ofroj mjete për nevojtarët dhe të dëmtuarit;
- ❖ Përkrah dhe zhvilloj biznesin dhe aftësitë individuale të talenteve etj.

III. Perspektiva e politikave fiskale

Korniza makroekonomike

Komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), prandaj Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2020-2022 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Parashikimi i të hyrave komunale

Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores mbi Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e

ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyra, siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Tabela 1. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

	Burimet e te hyrave	2019 Buxheti	2020	2021	2022
			Projeksioni		
1	Gjithsej grantet ndërqeveritare	1,656,606	1,490,747	1,540,076	1,594,971
1.1	Financimi nga Huamarrja ne Shëndetësi	14,602	-	-	-
2	Gjithsej te hyrat vetanake te komunës	113,557	137,199	145,555	153,931
2.1	Te hyrat nga gjobat ne trafik	5,700	-	-	-
2.2	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	7,231	9,000	9,200	9,400
2.3	Te hyrat nga urbanizmi	11,200	17,400	19,400	21,400
2.4	Te hyrat nga administrata	6,200	6,900	7,100	7,300
2.5	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	4,500	8,500	9,200	9,900
2.6	Te hyrat nga tatimi ne pronë	43,000	59,082	60,854	62,680
2.7	Regjistrimi i Automjeteve	7,600	6,800	7,000	7,200
2.8	Te hyrat nga shëndetësia	6,200	6,700	6,800	6,900
2.9	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	2,100	8,143	5,189	2,202
2.10	Të hyrat tjera	8,900	2,400	2,400	2,400
2.11	Të hyrat nga tatimi ne tokë	10,926	12,274	18,412	24,549
	TOTALI	1,784,765	1,627,946	1,685,631	1,748,902

Tabela 2. Vlerësimet e hershme të buxhetit 2020

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Viti buxhetor (2019)					Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2020)					Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2021)					Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2022)				
	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali
Zyra e Kryetarit	77.3	22.0	0.3	30.5		78.7	19.0	0.3	40		79.0	19.0	0.3	40		79.4	19.0	0.3	40	
K. Komunal	59.6	4.0				59.7	4.0				59.7	4.0				59.8	4.0			
D. per planifikim urban, Gjeodezi dhe kadaster	42.1	7.9			20	48.3	10.9			105	48.5	10.9			100	48.8	10.9			105
D. per Administratë të përgjithshme	86.6	36.7	6.7		120	82.3	38.7	6.7		13	82.7	38.7	6.7		26	83.0	38.7	6.7		20
D. Buxhet dhe Financave	62.8	7.6	0.2			64.0	7.9	0.2			64.3	7.9	0.2			64.6	7.9	0.2		
D. Ekon. Bujqësi, pylltari dhe turizem	52.4	10.1	0.6		155.4	53.1	10.1	0.6		200	53.3	10.1	0.6		264	53.5	10.1	0.6		167
D. Shërbimeve Publike	62.6	18.5	12.5		104	63.0	18.5	14.5		130	63.2	18.5	14.5		20	63.5	18.5	14.5		20
D. e Arsimit	35.9	2.7				36.3	4.8				36.5	4.8				36.6	4.8			
D. e Shëndetësisë	15.3	4.2				15.5	4.2				15.5	4.2				15.6	4.2			
ZKK	6.5					6.5					6.5					6.6				
TOTALI:	501.1	113.7	20.3	30.5	399	507.4	118.1	22.25	40	448	509.39	118	22.3	40	410	511.36	118	22.3	40	312
Arsimi fillor	279.1	22.9	5.0		10	299.3	23.9	6.0			300.5	23.9	6.0		50	301.7	23.9	6.0		150
Arsimi I mesem	116.6	10.7	3.7			120.7	10.7	4.2		10	121.2	10.7	4.2			121.7	10.7	4.2		
QKMF	220.4	22.1	5.7		8	227.5	24.1	6.2			228.4	24.1	6.2			229.4	24.1	6.2		
Mirqenia Sociale	10.4	3.5	1.5			10.5	3.5	1.5			10.5	3.5	1.5			10.6	3.5	1.5		
SUB TOTALI	1127.7	172.9	36.2	30.5	417	1165	180.3	40.2	40	458	1170.0	180	40.2	40	460	1174.7	180	40.2	40	462

SPECIFIKACION

BUXHETI KOMUNAL JUNIK	VITI 2019 (000 EURO)	VITI 2020 (000 EURO)	VITI 2021 (000 EURO)	VITI 2022 (000 EURO)
	1,785	1,884	1,890	1,897

IV. Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pas për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2019.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vjet si dhe të grandeve të qeverisë të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i grandeve të MF-ve.

Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal

Më datën 15.05.2019 kanë arritur Limitet e para buxhetore për komunat për periudhën 2020/2022. Granti fillestar i Qeverisë për Komunën e Junikut është si vijon:

Tabela nr. 3 Limitet fillestare sipas qarkores buxhetore 2020/01

Limiti fillestar	Granti i Arsimit	Granti i Shëndetësisë	Granti i Përgjithshëm	Gjithsej granti Komunal
2020-Kufijtë e financimit	446,695	245,286	798,766	1,490,747
2021-Parashikimet	448,929	255,097	836,050	1,540,076
2022-Parashikimet	451,173	265,301	878,497	1,594,971

Tabela nr.4. Projeksioni i të hyrave Buxhetore nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake 2020/2022 të Komunës së Junikut

K. K. Junik	Buxheti - 2020	Buxheti – 2021	Buxheti – 2022
Të hyrat nga granti qeveritar	1,490,747	1,540,076	1,594,971
Të hyrat vetanake	137,199	145,555	153,931
TOTALI	1,627,946	1,685,631	1,748,902

Tabela nr. 5. Korniza afatmesme buxhetore 2020/2022 sipas kufijve fillestar

K. K. Junik	Buxheti - 2020	Buxheti - 2021	Buxheti - 2022
Paga dhe mëditje	1,165,430.40	1,170,492.69	1,174,654.81
Mallra dhe shërbime	180,250.00	180,250.00	180,250.00
Shpenzime komunale	40,200.00	40,200.00	40,200.00
Subvencione	40,000.00	40,000.00	40,000.00
Investime kapitale	458,000.00	460,000.00	462,000.00
TOTALI	1,883,880.40	1,890,492.69	1,897,104.81
Burimet e financimit			
Granti i Qeverisë	1,490,747.00	1,540,076.00	1,594,971.00
Të hyrat vetanake	137,199.00	145,555.00	153,931.00
TOTALI	1,627,946.00	1,685,631.00	1,748,902.00

* Planifikimi është 1,883,880.40 kurse burimet sipas qarkores janë 1,627,946.00, kemi diferencë prej (255,934.40, për arsye të zvogëlimit të grantit të përgjithshëm në krahasim me vitin 2019 si pasojë e heqjes së kontigjencës për korrigjimin e formulës së grantit të përgjithshëm për komunat e vogla.

Më datën 07.08.2018 kemi pranuar Qarkoren Buxhetore 2020/02 për Komuna në të cilën janë të specifikuar struktura e shpenzimeve sipas Kategorive ekonomike për vitin 2020 dhe parashikimet për 2021-2022. Sipas kësaj Qarkoreje Buxhetore Buxheti total i Komunës së Junikut është i njëjtë me qarkoren e parë në shumë prej 1,627,946.00€, edhe përkundër kërkesës që ne kemi kërkuar mjete më shumë sipas KAB-it të hartuar në muajin Qershor. Struktura e shpenzimeve për Komunën e Junikut sipas Qarkores 2020/02 është:

- Paga dhe mëditje	1,161,458.00
- Mallra dhe Shërbime	172,899.00
- Shpenzime Komunale	36,200.00
- Subvencione dhe transfere	30,500.00
- Shpenzime Kapitale	226,889.00
Totali	1,627,946.00

Tabela nr. 6. Korniza afatmesme buxhetore 2020/2022 sipas Qarkores 2020/02

K. K. Junik	Buxheti - 2020	Buxheti - 2021	Buxheti - 2022
Paga dhe mëditje	1,161,458.00	1,224,980.00	1,174,654.81
Mallra dhe shërbime	172,899.00	172,899.00	172,899.00
Shpenzime komunale	36,200.00	36,200.00	36,200.00
Subvencione	30,500.00	40,000.00	40,000.00
Investime kapitale	226,889.00	211,552.00	222,256.00
TOTALI	1,627,946.00	1,685,631.00	1,748,903.00
Burimet e financimit			
Granti i Qeverisë	1,490,747.00	1,540,076.00	1,594,971.00
Të hyrat vetanake	137,199.00	145,555.00	153,931.00
TOTALI	1,627,946.00	1,685,631.00	1,748,902.00

* Planifikimi i buxhetit në kategorinë e pagave nuk është i mjaftueshëm dhe pritet që të ketë minus të theksuar në këtë kategori pasi që do të fillojë zbatimi i ligjit të pagave në vitin 2020 dhe mjetet e ndara në këtë kategori sipas qarkores 2020/02 nuk mjaftojnë për mbulimin e pagave për vitin 2020, minusi në këtë kategori do të jetë rreth 200,000.00 euro.

Në tabelën vijuese pas pranimit të limiteve finale do të paraqesim shpërndarjen e buxhetit final sipas programeve për vitet 2020/2022

Tabela nr. 7. Shpërndarja e shpenzimeve buxhetore për periudhën 2020/2022 pas qarkores së dytë

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2020)					Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2021)					Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2022)				
	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali
Zyra e Kryetarit	60.1	11.6	0.2	30.5		62.3	11.6	0.2	40		65.8	11.6	0.2	40	
K. Komunal	75.7	4.0				81.8	4.0				87.3	4.0			
D. per planifikim urban, Gjeodezi dhe kadastr	45.5	10.9			20	48.2	10.9			20	49.2	10.9			40
D. per Administratë të përgjithshme	76.6	38.7	6.7		40	81.1	38.7	6.7		0	83.0	38.7	6.7		0
D. Buxhet dhe Financave	60.7	7.9	0.1			64.5	7.9	0.1			66.5	7.9	0.1		
D. Ekon. Bujqësi, pylltari dhe turizem	47.9	10.1	0.4		120.89	50.4	10.1	0.4		151.55	51.3	10.1	0.4		132.06
D. Shërbimeve Publike	60.8	18.5	13.3		36	66.5	18.5	13.3		30	68.3	18.5	13.3		40
D. e Arsimit	32.4	4.8				33.9	4.8				36.0	4.8			
D. e Shëndetësisë	10.5	4.2				11.4	4.2				11.5	4.2			
ZKK	7.1					7.1					7.2				
TOTALI:	477.31	110.7	20.6	30.5	216.89	507.368	110.699	20.6	40	201.55	526.19	110.7	20.6	40	212.06
Arsimi fillor	296.0	23.9	4.9			306.5	23.9	4.9			322.6	23.9	4.9		
Arsimi i mesëm	122.1	10.7	3.6		10	127.4	10.7	3.6		10	134.0	10.7	3.6		10
QKMF	254.9	24.1	5.7			271.9	24.1	5.7			283.1	24.1	5.7		
Mirëqenia Sociale	11.1	3.5	1.4			11.8	3.5	1.4			11.9	3.5	1.4		
SUB TOTALI	1161.5	172.9	36.2	30.5	226.89	1225.0	172.899	36.2	40	211.55	1277.7	172.9	36.2	40	222.06
SPECIFIKACION															
BUXHETI KOMUNAL JUNIK	VITI 2019 (000 EURO)					VITI 2020 (000 EURO)					VITI 2021 (000 EURO)				
	1,628					1,686					1,749				

Strategjia e shpenzimeve sipas Drejtorive/Programeve dhe deklarata e misionit dhe qëllimeve

Kryetari: Agron Kuçi

ZYRA E KRYETARIT

Deklarata e misionit: Kryetari i komunës, përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj, udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij; ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës; emëron dhe shkarkon zëvendësit dhe drejtorët e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative e investuese, propozon Buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës; si dhe ndërmerr aktivitetet e tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo akte të tjera ligjore dhe nën ligjore të cilat janë në fuqi. Përgatitë të gjitha materialet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve etj. gjithnjë me qëllim të arritjes të një qeverisje sa më të mirë, koordinon punën me të gjitha drejtoritë etj. Ofron çasje në dokumente zyrtare në mënyrë të arritjes së një transparence sa më të madhe në punë, etj.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi primar është që të gjitha kompetencat e Komunës të rregulluara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës të zbatohen në përpikëri në mënyrë që misioni i Komunës të shënoj shkallën sa më të lartë të performancës duke i realizuar me sukses qëllimet strategjike komunale.

Kategoritë buxhetore	2020	2021	2022
1 Paga dhe mëditje	60,077.43	62,296.83	65,842.35
2 Mallra dhe shërbime	11,649.00	11,649.00	11,649.00
3 Komunalit	150.00	150.00	150.00
5 Subvencione	30,500.00	40,000.00	40,000.00
6 Kapitalet	-	-	-
TOTALI	102,376.43	114,095.83	117,641.35
Numri i te Punësuarve	8	8	8

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL

Kryesuesi: Muharrem Krasniqi

Deklarata e misionit: Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ i Komunës, i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale. Kuvendi i Komunës mund të miratoi aktet dhe të ndërmerr masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre e që vlejné brenda territorit të Komunës dhe në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, dhe atë: statutin e Komunës; rregulloren e punës; rregulloret komunale; dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin e komunës.

Deklarata e qëllimit: Zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, afirmimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ofrimin e për kujdesit publik shëndetësor, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale; turizmin, aktivitet kulturore dhe të lira, çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre apo që nuk është përcaktuar ndonjë autoritet tjetër.

Kategoritë buxhetore		2020	2021	2022
1	Paga dhe mëditje	75,736.71	81,792.92	87,293.58
2	Mallra dhe shërbime	4,000.00	4,000.00	4,000.00
3	Komunalit			
5	Subvencione	-		
6	Kapitalet	-	-	-
TOTALI		79,736.71	85,792.92	91,293.58
Numri i te Punësuarve		15	15	15

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**Drejtori: Leonita Jasiqi**

Deklarata e Vizionit: Ofrimi i shërbimeve efikase dhe të cilësisë së lartë, që u përgjigjen qytetarëve dhe i përmbushin nevojat e tyre.

Deklarata e Misionit: Udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet administrative – teknike të drejtorisë dhe ato të Shërbimit Civil Komunal që bien në këtë kompetencë. Udhëheqë me librat amë, të gjendjes civile, lëshon certifikata të gjendjes civile, sjellë aktvendime për regjistrime të mëvonshme, përmirësime dhe ndryshime të emrit e mbiemrit personal, harton aktet normative që bien në kompetencë të drejtorisë, udhëheq punën e arkivit komunal, zyrën e pritjes, sektorin teknik dhe të mirëmbajtjes, logistikës, angazhohet dhe përcjellë punën e bashkëpunimit me vendbanimet dhe fshatrat. Gjithashtu kryen edhe punë të tjera që janë kompetencë e drejtorisë e që janë të bazuara në ligje, statut të Komunës, rregullore dhe udhëzime administrative, të cilat janë në fuqi.

Deklarata e Qëllimit: Koordinimi i punës me Drejtoritë Komunale në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Junikut. Pranimi i lëndëve nga palët dhe procedimi i tyre në zyrat e administratës Komunale, dhënia e informatave për palët lidhur me kërkesat dhe ankesat e tyre. Pajisja e palëve me kohë dhe në mënyrë transparente me dokumentacion personal nga librat e amzës. Përgatitja dhe plasimi me kohë në ueb-faqe të informatave për ecuritë, të arriturat dhe punën në Administratën Komunale si dhe shërbime të tjera që janë në kompetencë të drejtorisë në fjalë.

Kategoritë buxhetore		2020	2021	2022
1	Paga dhe mëditje	76,640.13	81,134.64	83,043.12
2	Mallra dhe shërbime	38,700.00	38,700.00	38,700.00
3	Komunalit	6,700.00	6,700.00	6,700.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	40,000.00	-	-
TOTALI		162,040.13	126,534.64	128,443.12
Numri i te Punësuarve		14	14	14

Të hyrat vetanake		2020	2021	2022
1.	Te hyrat nga Administrata (Gjendja Civile LAL, LAM etj)	6,900	7,100	7,300
2.				
3.				
TOTALI:		6,900	7,100	7,300

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtori: Kosovare Gacaferi

Deklarata e Vizionit: Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të jetë çdo herë e saktë në planifikime, e besueshme dhe transparente.

Deklarata e Misionit: Menaxhon dhe operon me mjetet buxhetore të Komunës, i siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon lidhur me aktualitetet e ndërlidhura me Buxhetin e Komunës. Përgatit raportet për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvend lidhur me menaxhimin e financave komunale, përgatitjen dhe prezantimin e Buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktivitetëve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin. Gjithashtu, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa hyn edhe Zyra e Tatimit në pronë, e cila ka si mision inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë, që dedikohen për projekte kapitale, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Deklarata e Qëllimeve: a) Planifikimi i saktë dhe efikas i Buxhetit
b) Shpenzimi i Buxhetit në mënyrë racionale dhe në përputhje me ligjet në fuqi
c) Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake komunale

Kategoritë buxhetore	2020	2021	2022
1 Paga dhe mëditje	60,697.71	64,499.67	66,496.23
2 Mallra dhe shërbime	7,900.00	7,900.00	7,900.00
3 Komunalit	100.00	100.00	100.00
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	-	-	-
TOTALI	68,697.71	72,499.67	74,496.23
Numri i te Punësuarve	9	9	9

Të hyrat vetanake	2020	2021	2022
1. Te hyrat nga Tatimi ne pronë	59,082	60,854	62,680
2. Te hyrat nga regjistrimi i automjeteve	6,800	7,000	7,200
3. Te hyrat nga tatimi ne tokë	12,274	18,412	24,549
4. Te hyrat tjera	2,400	2,400	2,400
TOTALI:	80,556	88,666	96,829

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE INSPEKSIONI**Drejtori: Myrtë Velijaj**

Deklarata e misionit: Misioni i përgjithshëm i DSHP-së është realizimi i suksesshëm i Planit për Parandalimin e Emergjencave, reagimin e shpejtë dhe të suksesshëm ndaj emergjencave, intervenime të suksesshme të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, rritjen e performansës në Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit, rritjen e performansës në transportin publik të udhëtarëve, ndriçimin elektrik të qytetit si dhe rritjen e performansës në ndërmarrjet publike për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi i drejtorisë do të jetë ndërtimi dhe riparimi i rrugëve të qytetit dhe atyre lokale, ndërtimi i rrjeteve të reja të ujësjellësit, ndërtimi i rrjeteve të reja të kanalizimit të ujërave të zeza, ndërtimi i parqeve, shesheve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara, ndërtimi i rrjeteve të reja të ndriçimit publik.

Kategoritë buxhetore		2020	2021	2022
1	Paga dhe mëditje	60,830.28	66,545.92	68,328.67
2	Mallra dhe shërbime	18,500.00	18,500.00	18,500.00
3	Komunalit	13,250.00	13,250.00	13,250.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	36,000.00	30,000.00	40,000.00
TOTALI		128,580.28	128,295.92	140,078.67
Numri i te Punësuarve		9	9	9

Të hyrat vetanake		2020	2021	2022
1.	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	8,143	5,189	2,202
2.				
3.				
TOTALI:		8,143	5,189	2,202

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK**Drejtori: Leonard Lolluni**

